



„Projekti është i financuar nga BE-ja“



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
МЕЃУНАРОДНА
СОРАБОТКА

СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО
МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

Debati “Vetërregullim mediatic – rezultate, sfida, perspektiva”

Data e mbajtjes: 13.06.2019

Vendi: hotel Milenium, Manastir

Qëllimi i debatit

Debati mes përfaqësuesve të KEMM-it dhe mediave, institucioneve dhe sektorit qytetar u organizua me qëllim që të diskutohet për mënyrën në të cilën bëhet vetërregullimi mediatic, rezultatet e deritanishme në punën e Këshillit për etikë në media, si dhe për praktikën e komunikimit me opinionin, transparencën dhe llogaridhënien e organizatës. Njëra prej qëllimeve kryesore të takimit ishte që të tregohet se organizata vazhdon të komunikojë drejtpërdrejt me opinionin, për shkak të përcaktimit më të lehtë të nevojave të qytetarëve në raport me punën e mediave, por edhe për shkak të lidhjes së tyre të ndërsjellë përmes dallimit të KEMM-it si organizatë që e lehtëson këtë proces dhe kontribuon në profesionalizimin e informimit të gazetarëve dhe realizimin e nevojës së opinionit për informim cilësor dhe objektiv.

Më tutje qëllimi i debatit ishte që edhe opinioni të njoftohet me konstatimet e KEMM-it nga ndjekja e punës së mediave në periudhën parazgjedhore dhe zgjedhore në shtet.

Prezantim i aktiviteteve të KEMM-it

Drejtorja Ekzekutive e KEMM-it, Marina Tuneva, theksoi se që në fillim u kuptua nevoja që organizata të vepronte në një mënyrë që do të përshtatej me kontekstin, klimën në raport me funksionimin e medias dhe nevojave të opinionit për një trup vetërregullues, që në njëfarë mënyre ndryshon nga mënyra se si funksionojnë këto trupa në vende të tjera evropiane, ku fokusi kryesor është marrja e ankesave nga opinionin, qytetarët dhe

Aktiviteti është financuar nga BE-ja dhe është pjesë e Programit „Shoqëri e qëndrueshme qytetare: financim shtetëror i organizatave qytetare“ që e zbaton Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS), Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Qytetare (BCSDN) dhe Qendra për Informim, Bashkëpunim dhe Zhvillim të Organizatave Qytetare nga Sllovenia (CNVPS)“.



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
МЕЃУНАРОДНА
СОРАБОТКА

СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

institucionet në lidhje me informimin joprofesional mediatic. "Ne që në fillim kuptuam se roli ynë duhet të jetë më aktiv, për shkak se bëhet fjalë për një koncept të ri për të cilin është e nevojshme të sigurojmë mirëkuptim nga opinioni, mediat dhe institucionet dhe, gjithsesi, bashkërisht të kuptojmë se me përpjekje të përkushtuara dhe koordinuara, mund të kontribuojmë në të kuptuarit e vetërregullimit, por edhe në ndihmën për mediat. Gjëja më e rëndësishme është se ne kemi një mirëkuptim të përbashkët se opinioni ka nevojë për informacione cilësore, të vërteta dhe objektive", tha ajo.

KEMM-i, gjegjësisht vetërregullimi, funksionon në atë mënyrë që përmes ankesave të pranuar nga opinioni ndërlidhet me mediat dhe ngrihet procesi i ndërmjetësimit, me qëllim që të mundësojë korrigjimin e gabimeve në informimin e gazetarëve. Tuneva theksoi se fillimisht organizata është përballur edhe me rezistencë, mosnjohje dhe mospranim të vetërregullimit, por njëra prej përparësive kryesore është fakti se ekziston një lidhje e fortë mes organeve të Këshillit, të cilat veprojnë bashkërisht në drejtim të promovimit efektiv të vetërregullimit, dallimit të pengesave dhe barrierave, si dhe mundësive për afirmimin e këtij koncepti të punës në interes të opinionit dhe mediave.

Vetërregullimi efektiv, mes tjerash, do të thotë se mbrohet pavarësia redaktuese dhe parandalohen ndikimet e qendrave të ndryshme të fuqisë, veçanërisht duke marrë parasysh konstatimet e raporteve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare në lidhje me lirinë e shprehjes dhe lirinë e punës së mediave.

Duke iu referuar konstatimeve nga monitorimi i mediave gjatë zgjedhjeve presidenciale në shtet, Tuneva theksoi se ka qenë i pakonsiderueshëm numri i ankesave të parashtruara që kanë qenë lidhura në mënyrë strikte me informimin e mediave për zgjedhjet. Sipas saj, në informimin mediatic është vërejtur një ndarje në "tanë dhe tuaj", fokus i fortë në palët e ndara, ndërsa mediat nuk kanë bërë përpjekje serioze për gazetari më analitike, për ndjekje më të thellë të zhvillimit të disa temave. "Nga skena mediatike mungonte gazetaria e angazhuar dhe analitike. Mediat jo rrallë na drejtoheshin me kërkesa për të komentuar fushatën e kandidatëve presidencialë dhe mënyrën në të cilën kjo është reflektuar në informimin mediatic. Qëndrimi ynë ishte se një dozë e shëndetshme e negativitetit në këtë qasje ishte e mirë, por kishte media që e shfrytëzuan gjithë këtë në mënyrë sensacionale,

Aktiviteti është financuar nga BE-ja dhe është pjesë e Programit „Shoqëri e qëndrueshme qytetare: financim shtetëror i organizatave qytetare“ që e zbaton Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS), Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Qytetare (BCSDN) dhe Qendra për Informim, Bashkëpunim dhe Zhvillim të Organizatave Qytetare nga Sllovenia (CNVPS)“.



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
МЕЃУНАРОДНА
СОРАБОТКА

СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

duke krijuar konstruksione për të përcjellë porosi të caktuara drejt opinionit, gjë që shpinte drejt dëshpërimit dhe humbjes së besimit në vetë politikanët", përshkroi drejtorja e KEMM-it..

Është i pakonsiderueshëm numri i ankesave për lajme të rrejshme gjatë periudhës së zgjedhjeve, por megjithatë janë regjistruar raste të informimit joprofesional në disa portale të caktuara të internetit, gjë që, nga ana tjetër, ka ndikuar në atë që KEMM-i të vazhdojë në mënyrë aktive diskutimin për mënyrën në të cilën këto media do të kishin pranuar vetërregullimin dhe standardet e punës profesionale. "KEMM-i, ndonëse nuk merr vazhdimisht ankesa për lajme të rrejshme, ajo që e vëren si tendencë është informimi i njëanshëm dhe dezinformimi. Nëse kemi dezinformata dhe informim të njëanshëm, vetëm njërën anë të tregimit, atëherë nuk është e vogël mundësia që të përballemi edhe me lajme të rrejshme. Të gjitha këto dukuri janë të ndërlidhura, ndërsa roli i trupit vetërregullator shpeshherë ka qenë në fokusin e vëmendjes se si flitet për mënyrën në të cilën duhet të përballemi", tha Tuneva.

Duke u ndërlidhur rreth mënyrës së përballjes me lajmet e rrejshme, kryetarja e Këshillit drejtues të KEMM-it Katerina Sinadinovska theksoi se të jesh gazetar nuk do të thotë vetëm të transmetohet qëndrimi personal ose i dikujt tjetër, por roli i gazetarisë duhet të jetë absolutisht i përgjegjshëm, veçanërisht në demokracitë e dobëta dhe në shoqëritë në zhvillim siç është kjo e jona. "Këtu diku, midis misionit të gazetarisë dhe interesave të tjera të grupeve të biznesit dhe lobit politik që i financojnë strukturat e këtilla të maskuara si gazetarë, duhet të kërkohet zgjidhje se si të arrijmë deri te informacioni mirëfilltë dhe si të luftojmë me ata njerëz të cilët gazetarinë e shfrytëzojnë për t'i fshehur qëllimet e vërteta, dhe kjo është zhatja", tha Sinadinovska.

Qëndrimi i KEMM-it, sipas Sinadinovskës, është se nuk ka nevojë për rregullimin e portaleve të internetit. "Në një sferë të këtillë delikate, siç është liria e fjalës, zgjidhjet ligjore mund të jenë një problem serioz. Nga ana tjetër, lënia e lirisë së plotë sjell anarki, kështu që ka situata në të cilat secili mund të hapë një portal, nuk ka impresum, nuk ka redaksi, nuk ka as emër, nuk dihet se kush i shkruan lajmet, nuk respektohet asnjë standard, nuk e dimë as se sipas cilit kod funksionon. Të hasur në një situatë të tillë, shqyrtuam disa shembuj

Aktiviteti është financuar nga BE-ja dhe është pjesë e Programit „Shoqëri e qëndrueshme qytetare: financim shtetëror i organizatave qytetare“ që e zbaton Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS), Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Qytetare (BCSDN) dhe Qendra për Informim, Bashkëpunim dhe Zhvillim të Organizatave Qytetare nga Sllovenia (CNVPS)“.



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
МЕЃУНАРОДНА
СОРАБОТКА

СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

nga rajoni, përvojat janë të ndryshme. Përpilua një listë të kriterëve me të cilat i obliguam portalet e internetit, nëse duan të jenë anëtarë, nëse duan të identifikohen me Këshillin e Etikës dhe në përgjithësi me standardet, t'i përmbushin këto standarde themelore. Kjo do të thotë që portalet e internetit të kenë një impresum, të jenë të regjistruar si persona juridikë, të dihet se sipas cilat kod punojnë, etj. Përveç kësaj, iu drejtua edhe bashkësisë afariste, gjegjësisht Odës ekonomike, prej ku kërkua që të jenë të rezervuar ndaj mediave që nuk i respektojnë këto standarde, të mendohet se ku investohet me reklamimin", theksoi Sinadinovska. Ideja jonë kryesore, tha Sinadinovska, ato media që nuk i respektojnë standardet, nuk kanë impresum, nuk janë të regjistruar, nuk kanë mision, t'i ekspozojmë në 'listën e turpit' dhe qytetarët të dinë se cilës media mund t'i besojnë, e ndaj cilës media të jenë të rezervuar. "Kjo është mënyra më e vështirë, por sipas mendimit tim, mënyra e vetme e shëndosh se si ne të pastrohemi brenda profesionit, sepse nëse ia lëmë këtë ta bëjë Qeveria, cilado qeveri, kjo do të mund të ishte e rrezikshme. Nuk mund të lejojmë që profesionin tonë ta rregullojë pushteti, po as një zgjidhje ligjore, sepse ky vend ka ligje, problemi është se si ato zbatohen. Ja, për shembull, gjuha e urrejtjes është vepër penale, për vite të tëra nuk ka pasur asnjë dënim, e nga ana tjetër, gjuhë të urrejtjes ka bollshëm. Pra, duhet doemos të gjithë aktorët e shëndoshë në gazetari të bashkohemi dhe të themi se çfarë dhe si më tutje, meqë të gjithë i kemi pasojat e njëjta", thekson kryetarja e KD të KEMM-it.

Kryetari i Komisionit për ankesa, Mirçe Adamçevski, në fjalën e tij, theksoi se Komisioni pranon gjithnjë e më shumë ankesa. "Edhe më tutje mungon saktësia, informacionet janë të pavërtetuara, parashtresat më së shumti kanë të bëjnë me atë. Gazetarët në vend se të japin fakte japin mendime të tyre në produktin e gazetarisë. Gazetarët në vend se të japin lajm fillojnë me komente ose, praktikisht, gjithë informacionin e kanë koment. Ka edhe raste të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit. Këto janë tri shkeljet kryesore të Kodit të gazetarëve", tha ai, duke bërë thirrje për parashtrimin e ankesave edhe nga qytetet tjera në shtet.. „Deri në fund të majit të këtij viti, kemi marrë dyzet parashtresa, që është befasuese për ne në kuptimin e numrit, për shkak se vitin e kaluar për të vitin kemi 68 parashtresa, ndërsa tani deri në muajin e pestë kemi mbi 40 parashtresa. Sipas përfaqësimit të mediave që kanë qenë objekt i ankesave gjatë vitit të kaluar thuajse 77% prej tyre janë portale të

Aktiviteti është financuar nga BE-ja dhe është pjesë e Programit „Shoqëri e qëndrueshme qytetare: financim shtetëror i organizatave qytetare“ që e zbaton Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMC), Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Qytetare (BCSDN) dhe Qendra për Informim, Bashkëpunim dhe Zhvillim të Organizatave Qytetare nga Sllovenia (CNVPS)“.



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
МЕЃУНАРОДНА
СОРАБОТКА

СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

internetit, më pas televizionet me rreth 18%, mediat e shtypura me 4,4%. Parashtrues më të shpeshtë të ankesave vitin e kaluar kanë qenë qytetarët 34%, më pas gazetarët dhe mediat me 25%, organizatat dhe shoqatat e sektorit civil me 22% dhe bartësit e posteve publike, institucionet publike, partitë me 19%”, sqaroi Adamçevski.

Diskutim – konstatime dhe rekomandime

Një pjesë e të pranishmëve e theksuan nevojën që KEMM-i të përfshihet në diskutimet për gjetjen e modeleve për financimin e mediave, duke marrë parasysh se pa u zgjidhur kjo çështje do të vihet në pikëpyetje ekzistenca e tyre.

Përveç kësaj, u kërkua edhe të punohet në mënyrë aktive në zgjidhjen e problemit me (vetë) rregullimin e portaleve të internetit, meqë praktika konfirmon se pjesa më e madhe e problemeve në informimin e gazetarëve vërehen pikërisht aty.

Është rekomanduar KEMM-i të përfshihet edhe në angazhimet për përhapjen e arsimit mediatic te qytetarët, niveli i të cilëve, sipas të pranishmëve, është i ulët dhe qytetarët nuk mund të dallojnë se si plasohen dezinformatat dhe propaganda.

Lidhur me transparencën dhe llogaridhënien e organizatës, sugjerohet sa është e mundshme më shpesh prania në komunat në mbarë shtetin, meqë në këtë mënyrë mundësohet të dallohet se çfarë ndodhë në ato mjedise, cilat janë nevojat e mediave dhe si mund të jenë qytetarët partnerë në procese të ndryshme. Në këtë drejtim, u theksua se ato media që ushtrojnë në mënyrë profesionale punën e tyre mund të përfshihen në aktivitetet për përhapjen e arsimit mediatic, të edukojnë për fenomenin e lajmeve të rrejshme dhe përballjen me të, luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe ngjashëm.

Me iniciativë të KEMM-it për formimin e Rrjetit kundër gjuhës së urrejtjes në mediat shikohet pozitivisht dhe inkurajohet që të punohet në lidhjen e mëtejshme me të gjithë që formalisht i janë bashkëngjitur kësaj iniciative, e veçanërisht duke marrë parasysh se institucionet deri tani nuk e kanë adresuar në mënyrë efektive fenomenin e gjuhës së urrejtjes, i cili ende ekziston. Në kontekst të funksionimit efektiv të këtij Rrjeti, u theksua se bashkëngjitja e mediave lokale, në bashkëpunim me KEMM-in, mund të jetë me interes të

Aktiviteti është financuar nga BE-ja dhe është pjesë e Programit „Shoqëri e qëndrueshme qytetare: financim shtetëror i organizatave qytetare“ që e zbaton Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS), Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Qytetare (BCSDN) dhe Qendra për Informim, Bashkëpunim dhe Zhvillim të Organizatave Qytetare nga Sllovenia (CNVPS)“.



МАКЕДОНСКИ
ЦЕНТАР ЗА
МЕЃУНАРОДНА
СОРАБОТКА

СОВЕТ ЗА ЕТИКА ВО МЕДИУМИТЕ НА МАКЕДОНИЈА

madh në dallimin e Rrjetit si një prej mënyrave më efektive për përballje me gjuhën e urrejtjes.

KEMM-i, sipas të pranishmëve, është histori që dallohet, duke marrë parasysh intensitetin e aktiviteteve deri tani, nga themelimi i kësaj organizate, por megjithatë ekziston nevoja që dikush të punojë në mënyrë aktive dhe të rregullt me mediat dhe sektorin civil në mbarë shtetin. Në këtë drejtim, u kërkua KEMM-i të llojë për mbështetje sa më të madhe në zbatimin e aktiviteteve në nivel lokal. Të pranishmit nga sektori civil theksuan se në bashkëpunim me mediat ata mund të jenë “zë i mirë” për vetërregullim në nivel lokal.

U rekomandua edhe të vazhdohet me praktikën e “shpërblimit” të gazetarisë profesionale, diçka në çka KEMM-i tashmë është përfshirë përmes organizimit të konkursit për tregime më të mira nga jeta shoqërore – sociale dhe tregime me të cilat avancohen dhe afirmohen të drejtat e grupeve të marginalizuara dhe të rrezikuara në shoqëri.

Aktiviteti është financuar nga BE-ja dhe është pjesë e Programit „Shoqëri e qëndrueshme qytetare: financim shtetëror i organizatave qytetare“ që e zbaton Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS), Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Qytetare (BCSDN) dhe Qendra për Informim, Bashkëpunim dhe Zhvillim të Organizatave Qytetare nga Sllovenia (CNVPS)“.